KURANI DHE SHKENCAT

KURANI DHE SHKENCAT

SAFVET SENIH

PRIZMI

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Ndalohet shumëfishimi, botimi, fotokopjimi dhe depozitimi elektronik, mekanik apo me anë të ndonjë sistemi tjetër regjistrimi i teksteve dhe figurave të krejt librit apo të një pjese të tij, pa leje me shkrim nga shtëpia botuese.

KURANI DHE SHKENCAT

SAFVET SENIH

Titulli i origjinalit në turqisht
KUR'AN VE İLIMLER

Përktheu: Arbër Qemali

ISBN: 978-9928-156-02-0

Kopertina: MS Design
Design: Indrit Isufi

Shtëpia Botuese "PRIZMI"
Adresa: Rr. Abdi Toptani
Torre Drin
K. 11, Nr. 112, Tiranë
www.prizmi.com

Tiranë, 2015

PËRMBAJTJA

Shkallët kuptimore të ajeteve 7
Të ikësh në hënë është e mundur 9
Në tokë çdo gjë është me masë 10
Qymyrguri 11
Caktimi juaj është në qiell 12
Çdo gjë për njeriun 13
Retë, elektriciteti dhe malet e breshërit 14
Nga vjen energjia e diellit? 15
Si ndikimi i radiacionit 16
Lënda e eterit 17
Njohja e fajtorëve 17
Allahu bën çdo gjë të flasë 19
As'habi Uhdud 20
Mrekullitë e Profetëve (a.s.) Dhe shenjat në Kuran për Ta 21
Shkenca dhe teknologjia në ajetet e Kuranit 27
Krijimi i universit 27
Universi është i rrumbullakët 28
Qiejt e mbështjellë 28
Ftohja e hënës 29
Universi zgjerohet 29
Ligjet e tërheqjes-shtytjes-ekuilibrit 30
Trajektoret 30
Përgjigje një kundërshtimi 31
Ndryshimi mes diellit dhe hënës 31
Dielli 32
12 Planetet 32
Rrumbullakësia e tokës 33
Toka rrotullohet 34
Toka ngushtohet nga polet 34
Kur ngjitesh lart pakësohet oksigjeni 35

Shtresa e atmosferës 35
Rrizku në thellësitë e tokës.....36
Erërat si pjalmuese 36
Energjia e lëvizjes 37
Një krahasim.....37
Fundi i diellit 38
Oqeanet do të digjen 38
Qielli do të skuqet si trëndafil e do të shkrijë si vaj 38
Malet do të shkrihen.....39
Më e vogël se atomi.....39
Çdo gjë është krijuar çift 40
Njeriu nga toka 40
Faktori përcaktues i gjinisë 41
Tre errësirat në barkun e nënës.....41
Shenjat e gishtërinjve 41
Frymëzimi që u vjen bletëve 42
Mjetet motorrike 42
Anija e hz. Nuhut nuk ishte me vela 43
Treni dhe mjetet e tjera 44
Tendosja sipërfaqësore {surface tension} 45
Koha dhe relativiteti.....45
Më shumë se tre dimensione 47
Elektriciteti.....47
Transmetimi i njëjtë i gjërave.....49
Transmetimi i aromave 50
Gjuha e shpendëve.....51
Qielli rrezatues dhe kthyes 52
Lënda e oksitosinit 53
Gërmat e koduara.....53
Qëllimi kryesor i Kuranit.....56

SHKALLËT KUPTIMORE TË AJETEVE

Profeti (s.a.s) në një hadith të tijin thotë: "Sigurisht që çdo ajet ka një kuptim të jashtëm (*dhahiri*), një kuptim të brendshëm (*batini*), një cak dhe një kufi të përcaktuar. Dhe për çdonjërën prej këtyre ka degë e sythe, ndarje dhe *funun* (kuptime për çështje dhe shkenca të ndryshme). {Dejlemi}.

Sipas asaj që kuptohet nga ky hadith, ajetet e Kuranit përmbajnë në vetvete shumë kuptime. Dhe ashtu duhet të jetë. Përderisa Kurani është shërimi i sëmundjeve trupore e shpirtërore i të gjithë njerëzve deri në kiamet, atëherë ai duhet t'i drejtohet të gjitha shtresave të ndryshme të njerëzve, në shekuj të ndryshëm, t'i japë mësim e të përmbushë nevojat e tyre. Dhe me të vërtetë, Kurani Famëlartë ka komunikuar me të gjithë, në çdo shekull, me çdo shtresë dhe botëkuptim.

Studiuesit e *fikh*ut (jurisprudencës islame) e kanë ndarë në katër shkallë kuptimin e ajetit, përkatësisht në: IBARE, DELALET, ISHARET, IKTIDA. Psikologjia nga i njëjti ajet nxjerr një ligj të vetin, sociologjia një parim të pandryshueshëm për jetën shoqërore, tasavufi një tjetër thellësi, ndërkohë që shkencat e tjera gjejnë në të rregulla të tjera për çdonjërën prej tyre.

Përpara se të kalojmë në studimin e çështjeve shkencore, le të japim ca shembuj sipas disa kuptimeve:

Në ajetin e 7-të sures Nebe', thuhet kështu:

"A nuk i bëmë malet si shtylla mbështetëse?"

Një person i thjeshtë e kupton në këtë mënyrë këtë ajet: vështron

malet që duken të ngulura si shtylla, mendon përfitimet dhe mirësitë tek to dhe falënderon Krijuesin.

Një poet arrin ta kuptojë në këtë mënyrë këtë ajet: shtresa e tokës është si një taban dhe qielli si një çadër madhështore e zbukuruar me llamba elektrike... dhe malet të cilat duken në fundin e qiellit i përfytyron si shtyllat e asaj çadre. Kështu adhuron plot admirim Krijuesin Fuqiplotë.

Një poet beduin arab këtë ajet e kupton kështu: sipërfaqja e tokës është shkretëtirë... vargmalet si të ishin çadra të shumëllojshme e të panumërta të beduinëve, - sikur- shtresa e tokës, mbi të ka të hedhura shtylla të larta, majat e mprehta të të cilave sikur kanë ngritur përpjetë perden e tokës e cila është vendbanimi i shumë krijesave.

Një gjeograf e kupton në këtë mënyrë këtë ajet: bota i duket si të ishte një anije që lundron në ajër dhe mbi oqeanin e eterit... malet i duken si të ishin direkë për ekuilibrin e asaj anije. I drejtohet të Plotfuqishmit që e ka bërë tokën si një anije, e cila duke na futur brenda saj, na shëtit gjithkund, duke thënë: "Të lartësoj Ty nga çdo e metë, veprat e tua janë madhështore."

Një gjykatës i shoqërisë njerëzore e kupton në këtë mënyrë ajetin: toka është si një shtëpi... dhe shtylla e jetës së asaj shtëpie është jeta e gjallesave. Dhe shtylla e jetës së gjallesave janë kushtet e domosdoshme të jetesës: uji, ajri dhe toka. Shtylla e ujit, ajrit dhe tokës janë malet. Sepse malet i shikon si depozitë uji, si një filtër ajri (pastron ajrin nga gazrat e dëmshëm) dhe si një thesar që ka naftë dhe minerale të rëndësishme për jetesën e njeriut. Pastaj, me një shenjë mirënjohjeje dhe madhërimi, falënderon Allahun, i Cili i ka krijuar malet e larta si shtylla në shtëpinë tonë që është rruzulli tokësor dhe i ka bërë ata si depo thesari për jetesën tonë.

Një filozof e kupton në këtë mënyrë këtë ajet: Tërmetet dhe tronditjet të cilat ndodhin si pasojë e çrregullimeve dhe

reaksioneve kimike në barkun e tokës, me ekzistencën e maleve gjejnë qetësi. Shkaku i vendosmërisë së tokës në trajektore dhe bosht si dhe i mosdaljes nga trajektorja vjetore nga tronditjet e tërmeteve, janë pikërisht malet. Duke kuptuar këtë si dhe rolin ajrues (filtrues) të maleve me vrimat e saj, arrin besim të plotë dhe thotë: "Urtësia i përket vetëm Zotit". Kështu arrin të shikojë mijëra urtësi dhe përfitime në çdo gjë.

TË IKËSH NË HËNË ËSHTË E MUNDUR

Në ajetin 33 të sures Rrahman: "*O grupim i xhindëve dhe i njerëzve, po patët fuqi për të kaluar përtej hapësirës së qiejve dhe të tokës, atëherë kalojini! Por ju kurrë nuk do të mundeni t'i kaloni përveç me fuqi (nga Allahu).*", tregohet në përgjithësi për mundësinë e udhëtimit në hapësirë. Domethënë, edhe nëse për momentin nuk është e mundur të shkohet në planetët dhe galaktikat e tjera, në të ardhmen, kur të përmbushen mundësitë, mund të realizohet një udhëtim i tillë. Për t'i shpëtuar forcës tërheqëse të tokës nevojitet një shpejtësi larguese prej 40.000 km në sekondë. Në vazhdimin e ajetit: "*Cilën nga mirësitë e Zotit tuaj e mohoni?*", tregohet se Zoti në të ardhmen do ta japë këtë mundësi.

Ajetet 18, 19, 20 të sures Inshikak, shpjegohen kështu në një vepër: *Pasha hënën kur vjen e plotë! Ju, patjetër që do udhëtoni nga një stacion (shkallë) në stacion. Ç'po ndodh me ta, pse nuk besojnë?* Në ajet, për daljen e hënës është përdorur fjala '*ittisak*'. Kjo fjalë ka kuptimin e mbledhjes dhe rrumbullakosjes në hënë të plotë.

Le t'i hedhim një sy fjalëve të thëna mbi këtë çështje në 1927: "*Dhe tani, ti o filozof i urtë,* që ke hyrë brenda një pike me dylbitë e mendimit tënd sa një pikë*, e me shkallën tënde të filozofisë u ngjite deri në hënë. Hyre brenda saj. Shikoje, hëna në vetvete është terr,*

errësirë. S'ka as dritë, as jetë. Puna jote vajti bosh, dija jote shkoi pa vlerë."

Në tefsirin e tij, Hamdi Yazër Elmallë, i komenton në këtë mënyrë ajetet e lartpërmendura: Duke u betuar në *ittisak*-un e hënës, domethënë në kohën kur ajo mblidhet e bëhet e rrumbullakët, thuhet:

"Patjetër që ju do ngjiteni nga shkalla në shkallë"

Sipas leximit të "*Leterkebenne*", urdhri i parë është për Profetin (s.a.s), i cili në ngritjen e tij në *Miraxh*, natën e *Isra*-së, u ngjit nga qielli në qiell, nga grada në gradë, nga posti në post, derisa iu afrua pranisë hyjnore. Sipas ibn Abasit dhe ibn Mesudit, ky përgëzim është pikërisht për të.

Në tasavuf, në ngritjen shpirtërore të evlijave drejt Arshit, hëna është pranuar si hapi i parë. Dhe kjo korrespondon dhe me hënën e cila qe stacioni i parë që njerëzimi arriti të shkojë në udhëtimin qiellor. Parë në këtë prizëm, pjesët që shkëputëm nga veprat e mësipërme të bëjnë të mendohesh.

NË TOKË ÇDO GJË ËSHTË ME MASË

"Çdo *gjë është e përcaktuar drejtë pranë Tij.*" (Rra'd/8)

"Dhe në tokë bëmë që çdo gjë të mbijë në masë të drejtë e të përcaktuar." (Hixhr/19)

"Dhe s'ka asgjë që Ne të mos kemi thesaret e saj. Por Ne e dërgojmë atë veçse në masë të caktuar." (Hixhr/21)

Sot, e kuptojmë më së miri se lëndët që formojnë bimët janë në masë të caktuar. Mungesa e fosforit ose e hekurit e bën të dobët bimën. P.sh. nëse natriumi nga 23 elektronet që ka, i jep një elektron klorit, natriumi nuk mbetet më natrium, formohet një

lëndë më vete, d.m.th. kripa. Nga e hidhët, bëhet e kripur.

Domethënë, kjo masë, "në çdo gjë", ndodhet dhe tek grimcat më të vogla si: atomi, elektroni, neutroni e protoni. Ngjarjet që ndodhin në laboratorin e tij të mistershëm kimik, edhe shkenca e sotme madje i kupton me vështirësi. Gazin dioksidit të karbonit që marrin nga uji në tokë dhe ajri që thithin, duke i bashkuar nën rrezet e diellit, prodhojnë sheqer sintetik. Dhe kjo del në gjendjen e shumë lëndëve të tjera. Ditën që do ia arrijmë të kryejmë këtë fotosintezë të tyre pa harxhime, prodhimi i sheqerit do të jetë akoma më i lehtë.

QYMYRGURI

"*Dhe Allahu i Cili nxjerr kullotën (lëndinat, bimët dhe pemët e ndryshme në pyje). Pastaj e bën atë kërcell të zi.*" (A'la/4-5). D.m.th. e solli në gjendje plehu dhe qymyri, me qëllim që detyra e tyre kryesore të jetë aftësia për të ndezur. "*Guthâ*" ka kuptimin e gjërave të mbledhura nga uji i rrjedhshëm që ka marrë përpara barërat, mbeturinat dhe i lë në cep të ndonjë përroi. "*Ehva*" merr kuptimin e errët, jeshile, e ngjyrave të mbyllura. Në Gjeologji dhe në Industrinë e Mineraleve flitet për mënyrën e formimit të karbonit të qymyrit gjatë djegieve të lëndëve.

Komentuesi i shquar i Kuranit, Hamdi Elmallë, i ka kushtuar plot 10 faqe shtjellimit të kësaj çështjeje.

Sipas asaj që tregon ajeti, bimët (pyjet), pas rrjedhjes së natyrshme të ngjarjeve, lihen mes shtresave të tokës, pastaj me kalimin e kohës ato male si smerald, kthehen në mineralin e qymyrit.

"Atëherë kini frikë zjarrin, lënda djegëse e të cilit janë njerëz dhe gurë." (Bekare/24)

Në fjalën arabisht "*uelhixhare*" (gurët), nuk ka më asnjë dyshim

se ajo përmban një kuptim udhërrëfyes për shkencën. Në të vërtetë, aludimi këtu për gurët janë statujat dhe idhujt. "*Vekud*" (shkrepëse dhe lëndë të tjera djegëse që shërbejnë për të ndezur zjarrin) që do ndezë zjarrin e xhehenemit, do jenë pikërisht njerëzit dhe idhujt që adhurohen. Por, në të njëjtën shprehje, lënda djegëse, njofton për ekzistencën e gurëve zjarrndezës si qymyri. Njëherazi edhe shkencëtarët thonë se ky është qymyrguri.

CAKTIMI JUAJ ËSHTË NË QIELL

"*Në qiell është rrizku juaj dhe çka ju është premtuar.*" (Dharijat/22)

Nxehtësia, drita dhe shiu që janë aq të nevojshme për ushqimin vijnë nga qielli. Bimët punojnë për t'i siguruar ushqimeve tona substancën e azotit. Sepse po të mos ishin këto punime, njerëzit dhe kafshët nuk do kishin mundësi të jetonin. E dimë se asnjë ushqim bimor, nuk mund të zhvillohet e të piqet pa një analizë kimike. 78% e ajrit përbëhet nga azoti. Kur rrufeja kalon nga atmosfera, bashkon një sasi azoti me oksigjen. Sasia e kësaj substance azoti është përafërsisht 3000 gram për çdo *ejken* (njësi matëse sipërfaqeje angleze). Dhe kjo është e barabartë me 300 *ratall* nitrat natriumi.

Të vërtetën e domosdoshmërisë tonë për ajrin, ujin dhe ushqimin, që kanë rënë dakord të gjitha shkencat, Kurani Famëlartë na e ka bërë të njohur shumë kohë më parë. Veçanërisht ajeti: *"Ai i Cili ju furnizon ju nga qielli dhe nga toka..."* (Neml/64) ka lidhje me këtë.

ÇDO GJË PËR NJERIUN

Në ajetin e 29 të sures Bekare thuhet:

*"Ai është i Cili krijoi për ju gjith*çka në tokë..."

Fjalët "*lekum*" dhe "*xhemian*" që përdoren në ajet, shprehin se gjithçka në tokë, pa përjashtim, është krijuar për njeriun, për përfitimin e tij. Vërtet, çdo gjë që ekziston, i siguron përfitime njeriut nga një pikëpamje, qoftë ajo edhe për të nxjerrë një mësim.

Tashmë është bërë e njohur se sa ilaç ideal është merimanga kundrejt dhimbjeve të reumatizmës, gjarpri me zile për verdhëzën dhe paralizën e fëmijëve, kobra për dhimbjet e vazhdueshme e të forta si dhe gjarpri i vogël i quajtur Bethrop që jeton në Brazil për hemorragjitë e forta, etj. Rendimenti i fabrikës artificiale të mëndafshit e pajisur me mjetet më moderne, është shumë modest në krahasim me atë të krimbit të mëndafshit. Zëri që arrin të nxjerrë një gjinkallë në varësi me trupin e saj, nëse do e nxirrnin veglat muzikore sipas madhësive të tyre, do thyheshin xhamat e do të shembeshin muret.

Drejtori i një fabrike baterish në Amerikë, pas studimeve që u bënë mbi peshqit elektrikë, tha këto fjalë: "Sikur të kishim edhe ne mundësi t'i bënim këto bateri!" Hunda e një pjese të lakuriqëve të natës ka formë patkoi. Kjo i bën ata të ndiejnë si radarët më të mrekullueshëm.

RETË, ELEKTRICITETI DHE MALET E BRESHËRIT

Benxhamin Franklin ka qenë i pari që zbuloi faktin se retë janë të ngarkuara elektrikisht (në 1752). Ndërkohë që Kurani e ka treguar këtë 1400 vjet më parë:

"Është Ai i cili jua shfaq juve shkreptimën si frikë dhe shpresë, dhe është Ai i cili ngre dhe sjell retë e rënduara me shi." (Rra'd/12)

Elektriciteti në ajër pengon që bulëzat e vogla të avullit të formojnë kokrra të mëdha shiu. Bulëzat e vogla kur kanë ngarkesa të njëjta elektrike shtyhen. Dy re me ngarkesa të kundërta elektrike kur bashkohen formojnë rrufenë, ngarkesa e tyre elektrike neutralizohet dhe nis të bjerë shi. "*Dërgon rrufetë*." (Rra'd/13) Kur era e fortë përplaset me retë, avujt e ujit ftohen, formohen pikat. Era pasi fërkohet me to i ngarkon ato elektrikisht.

Kur retë ecin, ngarkesa elektrike në tokë e ndjek atë dhe mundohet të gjejë mënyrat e arritjes së ngarkesës së resë, duke u ngjitur në pemë e ndërtesa. Në çastin që gjen gradën e mjaftueshme të voltazhit, midis ngarkesës elektrike në tokë dhe asaj të resë, del një shkëndijë. Në rrufe ka një fuqi prej 200.000 amperësh. Fundi i këtij ajeti (Rra'd/13) mbaron kështu: "*Forca dhe fuqia e Tij është e rreptë*." Nëse pranojmë shprehjen "*një shenjë për Fuqinë e Tij*", si tregues për rrufenë, arrijmë në kuptimin se "Çështja e transformimit, është shumë e fortë (rreptë).

Gjithashtu, në pjesën e ajetit: "*Ai zbret nga qielli male breshëri*", ndjehet shkëndija e një mrekullie tjetër. Sepse tashmë është bërë e njohur se në disa zona të Siberisë bien masa të mëdha breshëri dhe bore si male.

Profeti ynë (s.a.s.), i cili ka jetuar 1400 vjet më parë në zonën e nxehtë të Arabisë, nuk kishte mundësi të dinte diçka të tillë, e aq më pak të fliste mbi këtë çështje. Kjo veçanti, tregon se ato të vërteta që solli ai, ishin shpallje e vërtetë hyjnore.

NGA VJEN ENERGJIA E DIELLIT?

Dielli edhe pse harxhon pesë milionë tonë energji në sekondë, nuk e humbet nxehtësinë e tij. Megjithëse teoritë tregojnë për 564 milionë ton hidrogjen të shndërruar në helium, nuk janë në gjendje të na japin një arsyetim bindës. Si ndodh shndërrimi në helium dhe pse?

Në hadithet profetike ne shohim një lidhje mes tokës dhe xhehenemit. Sepse Profeti (a.s.) në një hadith të tijin, në lidhje me nxehtësinë e verës, thotë: "Ë*shtë nga vlimi i xhehenemit*." Meqenëse Tokës nxehtësia i vjen prej Diellit, edhe Diellit i vjen nga xhehenemi. Në një hadith tjetër, ai thotë: "*Xhehenemi ndodhet nën tok*ë." Në fakt, konceptet lart dhe poshtë janë relative. Duke qenë se është më poshtë se Xheneti, ka mundësi të jetë përdorur një shprehje e tillë. Sipas kësaj, i bie që xhehenemi të jetë nën trajektoren që bën toka rreth Diellit. Fakti që nuk ndjehet dhe nuk shikohet, ndodh ngase është zjarr me perde dhe pa dritë.

Në hapësirat e mëdha që lëviz toka, ka shumë krijesa që nuk shihen për shkak se ata janë pa dritë. (Ashtu siç nuk shihen normalisht rrezet ultraviolet dhe rrezet infra të kuqe). Ashtu si hëna kur i ikën drita nuk mund të shihet dot, shumë krijesa pa dritë edhe pse mund të jenë para syve tanë nuk mundemi t'i shikojmë. Nuk mund të jetë larg fuqisë së Allahut që ta bëjë Xhehenemin si një kazan fabrike të llambave elektrike e me to të ndezë yjet e qiellit, t'u japë atyre nxehtësi dhe forcë.

Në Kuran, në ajetin 97 të sures Isra, thuhet: "*Vendbanimi i*

tyre do të jetë Xhehenemi; sa herë që do t'i ulet vala, Ne do t'ua shtojmë rreptësinë e zjarrit." Zjarri vazhdimisht i përtëritshëm i xhehenemit, vazhdimisht ushqen Diellin dhe yjet e tjerë.

SI NDIKIMI I RADIACIONIT

Kur tregohet për dënimin dhe vuajtjet e popullit të Lutit (a.s.), ndjehemi sikur përballemi me ndikimet e ndryshme të bombës atomike. Sigurisht që populli i Lutit nuk u shkatërrua nga një bombë atomike. Por përmbysja e qytetit dhe ndikimet që patën ata që e panë këtë përmbytje nga larg, atyre që kanë njohuri mbi atomin, u jep njohuri për dijen dhe fuqinë e Zotit. T'i hedhim një sy me kujdes shprehjeve: "*(O Lut!) Udhëto ti me familjen tënde në një pjesë të natës dhe asnjëri prej jush të mos shohë nga pas. Përveç gruas tënde. Padyshim se ndëshkimi i cili do i godasë ata, do godasë edhe gruan tënde. "* (Hud/81)

Në një vend tjetër, e njëjta ngjarje tregohet kështu: *"Pastaj udhëto në pjesën e fundit të natës me familjen tënde dhe ti shko pas tyre në fund e mos lejo kënd nga ju të kthejë kokën pas e të shohë, por vazhdoni drejt e atje ku jeni urdhëruar. "* (Hixhr/65)

Dhe: *"Por britma tronditëse i përpiu ata përpara agimit. Dhe Ne i kthyem përmbys qytetet (Sodomit) e tyre duke derdhur mbi ta gurë nga balta e pjekur.*" (Hixhr/73-74)

Cila ishte ajo ngjarje e fuqishme që e përmbysi qytetin pa rënë ende rrebeshi i gurëve? Deri ku shkonte ndikimi i saj? Përse do të kishte një ndikim të tillë edhe mbi atë që do të kthehej pas të shikonte? Këto janë të vërteta këmbë e krye, që mund të shpjegohen vetëm me njohuritë e sotme mbi atomin. Ndaj dhe në Kuranin Famëlartë, në një ajet të tijin, thuhet kështu: "*Ne do t'u shfaqim atyre Shenjat Tona në gjithësi dhe në vetveten e tyre,*

derisa t'u bëhet e qartë se ky (Kurani) është *e vërteta. A nuk mjafton për Zotin tënd se Ai është Dëshmues për gjithçka?*" (Fusilet/53), duke shenjuar se shumë të vërteta që ndodhen në Kuran, do të kuptohen më vonë me zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë.

LËNDA E ETERIT

Duke studiuar krijimin e universit, ajeti 7 i sures Hud thotë: *"Dhe Ai është Allahu, i Cili ka krijuar qiejt dhe tokën në gjashtë ditë dhe Arshi (Froni) i Tij ishte mbi ujë."* Sipas komentimit që i bëhet këtij ajeti në një libër tefsiri, thuhet kështu: "Aludohet për lëndën e eterit, dhe Arshi i Allahut ka zbritur mbi lëndën e eterit që është si trajtë e ujit. Pasi është krijuar lënda e eterit, u bë qendra e krijimeve të para të Krijuesit. Domethënë, eteri u shndërrua në atome.

Sërish, në të njëjtën vepër, janë edhe këto pasazhe: "Lënda e Eterit është një faqe e këndshme dhe e bindur e veprimtarisë së Krijuesit Fuqiplotë, si dhe një mjet shpërndarjeje i urdhrave dhe një perde e hollë e veprimtarisë, dhe një bojë shkrimi e këndshme, dhe një vepër e lëngshme dhe një arë farërash e tillë që është një lëndë e palëvizshme, pa ndjenja e vullnet që ka mbytur materialistët, që është më e vogël se atomet dhe më e dendur se hejula që ka devijuar shumë filozofë.

NJOHJA E FAJTORËVE

"*Do të njihen fajtorët nga fytyrat e tyre (shenjat e nishanet) dhe do tërhiqen prej ballukesh e për këmbësh.* " (Rrahman/41)

Në këtë ajet tregohet për kapjen e mëkatarëve prej këmbësh e

zverku dhe hedhjen e tyre në xhehenem. Nga kjo frazë e Kuranit, që është udhërrëfyes në shumë fusha, krahas shprehjes së hedhjes së mëkatarëve në xhehenem, kuptojmë se fajtorët kur merren në pyetje këtu, në botën tonë, u rritet presioni i gjakut në tru, kanë ndryshime të befasishme në aspektin nervor dhe në reflekse, duke bërë që fytyrat dhe këmbët e tyre të pësojnë ndryshime anormale. Këto simptoma ndihmojnë në njohjen dhe në kapjen e tyre.

Shenjat e gishtave, të pëllëmbës së dorës dhe këmbëve janë argumente bazë për policinë. Shenja e gishtave është diçka që nuk ka asgjë të përbashkët as me një pjesë të shenjave të gishtave të tjerë. Dhe kjo ka qenë kurdoherë një mirësi e madhe pasi ka bërë të mundur kapjen e fajtorëve, duke mos dhunuar lirinë e shumë të pafajshmëve si dikur. Fraza pasardhëse e ajetit: *"Cilin nga mirësitë e Zotit tuaj përgënjeshtroni?* tregon për anën pozitive që i jepet kësaj çështjeje me anë të shkencës dhe teknologjisë.

Gjithashtu në Kuran ka edhe një ajet tjetër i cili flet për gjetjen e një fajtori. Por për momentin nuk mund të themi se ç'mësim mund të nxjerrë prej saj mjekësia: "*Kujtoni kur Musai i tha popullit të tij: 'Allahu ju urdhëron të therni një lopë'.* E më pas, '*Veçoritë e saj janë kështu: As shumë e vjetër, e as shumë e re, por e ndërmjetme dhe e fortë. Ajo është e paushtruar në punimin e tokës e në ujitjen e fushave, ka ngjyrë të verdhë që i jep gëzim atyre që e shohin* " (Bekare/67-69 dhe 71)

Pasi u ther lopa, shkaku i therjes së saj shpjegohet kështu: *"(O bijtë e Izraelit) Kujtoni edhe kohën kur ju vratë një njeri dhe u grindët mes jush për krimin. Dhe është Allahu që e nxori në shesh atë që ju e fshihnit. Kështu, Ne thamë: "Prekeni atë (të vdekurin) me një copë mishi të lopës'. (Ata e prekën të vdekurin dhe ai duke treguar shenja gjallërie kallëzoi për vrasësit, dhe doli haptazi krimi) Kështu Allahu sjell në jetë të vdekurit duke ju treguar juve kësisoj argumentet e Tij që të mësoni.*" (Bekare/72-73)

Edhe pasi ndahet njeriu nga shpirti e ka ndodhur vdekja, në

organizmin e tij disa organe nuk i humbasin menjëherë disa veti bimore e shtazore. P.sh., nëse një njeri vdes pak kohë pasi është rruar, vërejmë se pas disa ditësh atij do t'i zgjaten qime në mjekër. Bretkosës edhe pasi t'i jetë prerë koka, reflekset e saj vazhdojnë edhe për një kohë. Nga kjo pikë, gjendemi ballë për ballë me një të vërtetë të rëndësishme që ia vlen të diskutohet. I këshillojmë kompetentëve të studiojnë mbi këtë çështje.

ALLAHU BËN ÇDO GJË TË FLASË

"Derisa kur të arrijnë zjarrin, veshët, sytë dhe lëkurët e tyre do të dëshmojnë kundër tyre për ata që patën punuar. Dhe do t'u thonë (mohuesit) lëkurës së tyre: "pse dëshmon kundër nesh?" Ata do të thonë: Allahu na ka bërë të flasim, ashtu siç bën Ai çdo *gjë të flasë* . (Fusilet/20,21)

"Sot Ne do t'u vulosim gojët atyre dhe Neve do të na dëshmojnë duart dhe këmbët e tyre." (Jasin/65)

"Ne kemi një libër i cili flet të vërtetën; atyre nuk u bëhet pa drejtësi." (Mu'minun/62)

"Dhe gjithçka Ne e kemi shënuar në llogari (si dëshmi) në Libër të Qartë." (Jasin/12)

"Dhe s'ka gjë të fshehtë në qiell dhe në tokë që të mos jetë në Librin e Qartë (Leuhi-Mahfudh)." (Neml/75)

Leuhi Mahfudh, Bota e Kuptimit dhe ajo e Shëmbëllimit, që janë secila një faqe e Dijes Hyjnore, janë nga një libër që bëjnë çdo gjë të flasë e të vërtetojë. Kur dëshiron, bën që çdo gjë ta nxjerrë në shesh me forma dhe të folura. Ashtu si janë magnetofonat që regjistrojnë zërat nga një libër i zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë, po ashtu edhe televizionet dhe kinematë që transmetojnë ngjarje,

janë nga një vërtetues për *Imami Mubin* dhe *Kitabi Mubin*. Pamjet kimike në univers, ngjarjet e dritës dhe nxehtësisë, dhe dallimet e gjatësisë së valëve që pa u përzier me njëri-tjetrin, regjistrohen me dridhjet e tyre në univers.

"Studimet shkencore vërtetojnë se çdo gjë, si në errësirë dhe në dritë, ashtu edhe në prehje ose lëvizje, në çdo vend e në çdo gjendje, përhap një "nxehtësi". Kjo nxehtësi, ashtu si zërat që janë një pasqyrim i mrekullueshëm i valëve që vë në lëvizje gjuha, po ashtu pasqyron edhe të gjitha dimensionet e lëvizjeve ashtu si janë.

Sot është zbuluar mjeti i cili zbulon valët e nxehtësisë që dalin nga trupat. Gjithashtu ky mjet i cili në të njëjtën kohë arrin të japë edhe foto të mrekullueshme të trupave që përhapin valë nxehtësie (*heat waves*), mund të tregojë vetëm një kohë të shkurtër prej disa orësh të ngjarjes. Por, ngaqë valët e vjetra janë të vjetra, nuk kanë mundësi t'i tregojnë. Një natë në qiellin e Nju Jorkut u pa një avion i paidentifikuar. Shkencëtarët me anë të këtij mjeti zbuluan valët e nxehtësisë në qiell. Dhe kështu kuptuan formën dhe llojin e avionit. Këtij mjeti iu dha emri Evaporagraph.

AS'HABI UHDUD

"*Të mallkuar qenë populli i hendekut. Të zjarrit të furnizuar (pa masë) me lëndë djegëse. Kur ata qëndruan mbi të (zjarrin), dhe ata Dëshmuan çfarë ata po bënin kundër besimtarëve (duke i djegur ata). Ata nuk kishin asgjë kundër tyre vetëm se ata besuan në Allahun e Plotfuqishëm dhe të Lavdëruar.*" (Buruxh/4-8)

Ky ajet, përveçse flet për vuajtjen e besimtarëve para Epokës së Lumturisë (në të cilën jetoi Profeti) që u hodhën në kanale me zjarr, tregon për njerëz në të ardhmen të cilët, kur t'i jepen mundësitë teknologjike, mjetet e zjarrta do ndërmarrin të njëjtin

veprim. *Uhdud* dhe *hadd,* kanë kuptimin e hendekut dhe kanalit si dhe vendeve të mavijosura në trup nga rrahja me kamxhik. Ka edhe një shenjë për rrugët e trenit. "*Zjarr i furnizuar me lëndë djegëse*" tregon për mjetet e zjarrta veçanërisht TRENIN. "*Kur ata po qëndronin mbi të*" d.m.th., mbi mjetin e zjarrtë.

MREKULLITË E PROFETËVE (A.S.) DHE SHENJAT NË KURAN PËR TA

Kurani Famëlartë, në një ajet të tijin ,përsa i përket Profetit tonë (s.a.s) dhe profetëve të tjerë, thotë: *"Me të vërtetë tek i Dërguari i Zotit ka shembuj të mirë për ju".* (Ahzab/21*)*

"Me të vërtetë ka qenë një shembull i shkëlqyer për ju tek Ibrahimi dhe tek ata që ishin me të." (Mumtehine/4)

"*Usve*" do të thotë shembull i mirë që i shkohet nga pas. Ajetin e parë, Elmallë e komenton në këtë mënyrë: "Profeti (a.s.) është shembull për t'u ndjekur jo vetëm nga fjalët, por edhe nga veprat dhe gjendja e tij. Domethënë, Profeti nuk u mjaftua vetëm me shpjegimin e teorisë së fesë dhe moralit, por ka treguar me një shembull të mirë e konkret të gjitha veprimet deri në detaje, në kohë lufte apo në kohë paqeje."

Allahu i Madhëruar, ashtu siç i dërgoi profetët si një shembull të përsosur nga ana e besimit dhe moralit, me mrekullitë që i dha secilit prej tyre, i bëri ata udhërrëfyes për zhvillimin shkencor e teknologjik. Sepse fraza e përdorur në ajet: "*Shembull i mirë*" ashtu siç vërteton qenien e tyre si shembulli më i mirë, urdhëron edhe bindjen ndaj atyre në mënyrë absolute në çdo gjendje.

Parë nga ky këndvështrim, përmendja e përsosmërive shpirtërore të profetëve (besimi dhe morali i tyre) të nxit për

përfitim prej tyre. Po ashtu, edhe në përmendjen e mrekullive të të Dërguarve, ka nxitje për të arritur në të ngjashmen e tyre. Madje, mund të thuhet se, ashtu si përsosmëritë shpirtërore, edhe përsosmëritë materiale dhe gjërat e mrekullueshme u janë bërë dhuratë njerëzimit pikërisht me anë të këtyre mrekullive.

Pra, anija e Hz. Nuhut (a.s.) si mrekulli, ora e Hz. Jusufit (a.s.) si mrekulli, ajo që ia bëri dhuratë njerëzimit më së pari ishte dora e mrekullive. Në këtë të vërtetë ka diçka të bukur, pasi shumica e artistëve (zejtarëve) kanë një profet si udhërrëfyes. P.sh., anijendërtuesit Hz. Nuhun, orëndreqësit Hz. Jusufin, rrobaqepësit Hz. Idrisin (a.s)…

Po, studiuesit e Kuranit dhe të gjuhës janë të një mendimi se çdo ajet i tij përfshin në vetvete shumë rrugë dhe degë udhëzimi. Atëherë, ajetet më të ndritura të tij, ajetet që flasin për mrekullitë e profetëve, nuk mbeten thjesht vetëm si një histori (rrëfim), por përfshijnë brenda tyre shumë kuptime udhërrëfyese.

P.sh.; *"Edhe Sulejmanit Ne i nënshtruam erën, fluturimi i një dite ishte sa një muaj.."* (Seb'e/12)

Pra, ky ajet na tregon se njerëzimi e ka udhën të hapur, le ta kryejë një rrugë të tillë në ajër. Atëherë, o njeri! Përderisa rrugën e ke të hapur, avitu dhe arrije këtë gradë. Allahu i Madhëruar me këtë ajet sikur thotë: O Njeri! Një robi im (Sulejmani) braktisi kënaqësitë trupore dhe unë e hipa atë në ajër. Nëse edhe ju e braktisni dembelizmin dhe dini të përfitoni mirë nga ligjet e mia, mund të hipni si ai.

Ajeti që tregon për mrekullitë e Hz. Muasit (a.s): "*Kur Musai pati kërkuar një për popullin e tij dhe Ne i thamë: 'Bjeri gurit me shkopin tënd'. Pastaj që andej u derdhën me vrull dymbëdhjetë burime*". (Bekare/60)

Ky ajet tregon se me mjete të thjeshta mund të përfitohet nga thesaret e mëshirës që ndodhen nën tokë. Origjina e maleve është

vërtetuar shkencërisht se vjen nga një lëng i ngrirë që është bërë si gur. Lutja e Profetit tonë "Madhëroj dhe lartësoj Allahun i Cili ka shtruar tokën mbi ujë të ngrirë nga çdo e metë", padyshim që flet për këtë. Krijimi i parë i tokës është kështu; një lëndë si uji, ngrin e bëhet gur me urdhrin e Zotit, pastaj guri me lejen e Allahut bëhet dhé.

Le të shohim mrekullinë e Hz. Isait (a.s): *"Do të shëroj atë që ka lindur i verbër dhe atë që vuan nga lebra dhe do të ngjall të vdekurit me Vullnetin dhe Urdhrin e Zotit"* (Al Imran/49). Ky ajet tregon se "edhe sëmundjeve më të pashërueshme mund t'i gjendet shërimi. Çdo sëmundje, cilado qoftë ajo, është e mundur t'i gjendet shërimi (kura). Kërkojeni, gjejeni! Madje edhe vdekjes është e mundur t'i japësh një ngjyrim jete të përkohshëm. Ja, pra, ky ajet na tregon dhe na nxit drejt caqeve që zhvillimi shkencor i mjekësisë ende nuk i ka arritur."

Gjithashtu rreth mrekullisë së Hz. Ibrahimit (a.s): *"Ne thamë: O zjarr! Bëhu i ftohtë dhe paqe e siguri për Ibrahimin"* (Enbija/69), ka tri domethënie të këndshme:

E para: Vetë zjarri, ashtu si edhe shkaqet e tyre natyrore nuk vepron sipas dëshirës së vet apo rastësisht, por vepron nën urdhrin e dikujt, dhe nuk e dogji Hz. Ibrahimin, duke u urdhëruar "mos e digj!".

E dyta: zjarri ka një shkallë të ftohtë që djeg, d.m.th. ndikon po aq sa djegia. Allahu me fjalën "*selama*" i thotë të ftohtit: "ti mos digj si i nxehti." D.m.th., ajo shkallë e zjarrit, me të ftohtin e saj, të djeg si të ishte i nxehtë. Edhe është zjarr, edhe është i ftohtë. Në fizikë, zjarri në gjendje prushi të bardhë ka një shkallë të tillë që nuk përcjell ngrohtësi përreth. Dhe ngase thith nxehtësinë e ambientit, me këtë trajtë të ftohti, ngrin gjërat e lëngshme përreth dhe i djeg me të ftohtin e saj.

Pra *zemheriri*, është një gradë e zjarrit që djeg me të ftohtin e saj. Atëherë është e detyrueshme që xhehenemi i cili përfshin brenda saj të gjitha llojet dhe gradët e zjarrit, të ketë në gjirin e sj

edhe "*zemheririn*". (Ajeti 13 i sures Insan flet për zemheririn). Në temperaturën -79°C gazi dioksidit të karbonit ka veti djegëse.

E Treta: Ky ajet na thotë se: "O populli i Ibrahimit! Bëhuni edhe ju si Ibrahimi, që rrobat tuaja të bëhen mbrojtëse si në këtë botë edhe në tjetrën ndaj armikut tuaj më të madh, zjarrit. Ashtu si duke i veshur besim shpirtit tuaj e bëtë mbrojtje kundrejt zjarrit, ka disa lëndë e materiale në tokë që Zoti ka ruajtur për ju. Ato ju mbrojnë juve nga dëmi i zjarrit. Kërkojeni, nxirreni dhe visheni!" Nga zhvillimet dhe zbulimet më të rëndësishme të njerëzimit është gjetja e lëndës së amiantit, që nuk e djeg zjarri. Dhe mbath një veshje që i reziston nxehtësisë.

Pyetje: Përse Kurani nuk i ka kushtuar një vend të gjerë çështjeve shkencore? Dhe përse i përmend ato me shenja të fshehta? Nuk mundej t'i shtjellonte më hapur?

Përgjigje: Kurani Famëlartë nuk ka zbritur si një libër shkencor. Kur ka gjetur rastin, vende-vende ka prekur tema shkencore. Në veçanti ka cekur temat e rregullit dhe ekuilibrit në tokë, që është vendosur nga rregullatori i tyre, Allahu i Madhërishëm, dhe duke na treguar se ky rregull vërteton ekzistencën e ahiretit, që do t'i japë fund të gjitha padrejtësive, si rrjedhojë ka tërhequr vëmendjet rreth mrekullive të krijimit dhe ligjeve të fshehta.

Nëse këto do të shtjelloheshin në mënyrë të qartë haptazi, mendjet e njerëzve në periudhat e pazhvilluara të shkencës nuk do e kuptonin dot atë dhe mund të shkonin deri në mohim. Nga kjo arsye, do të mbetej pas dore qëllimi kryesor. Dhe nuk do të ishte aspak e përshtatshme që për të kënaqur njerëzit e disa shekujve, të privosh njerëzit e shumë shekujve të mëparshëm.

Përshkrimi edhe i këtyre pak gjërave madje në Kuranin Famëlartë, vërteton qartazi për dijen e pafund të Zotit. Me tregimin për zhvillimet e fshehta shkencore në të ardhmen e errët, Kurani i lë të nënkuptojë xhematit (besimtarëve) të tij se këto ajete vijnë

nga Allahu, duke i dhënë myslimanëve një opinion të fortë për ardhjen e një dije që do të shpërndajë mjegullnajën shoqërorë të së ardhmes. Ata që i drejtohen Kuranit me këtë besim, kanë gjetur e kuptuar më së miri problemet dhe mundësitë e rrugëdaljes.

Bashkë me këto të vërteta, ne kuptojmë se Kurani Famëlartë i ka vërtetuar mendjes dhe shkencës të gjitha temat e saj. Ai përputhet plotësisht me zhvillimet e shkencës dhe teknologjisë, duke nxitur kështu në përdorimin e teknologjisë dhe shkencës për ngritjen nga ana materiale të myslimanëve dhe kryerjen e misionit të përcjelljes së mesazhit hyjnor.

Si rrjedhojë, edhe vendi që ato do të zënë në Kuran, vetëm kaq mund të jetë. Sepse misioni kryesor i Kuranit është:

a) Të tregojë madhështinë e Allahut dhe cilësitë e Tij të përsosura me anë të veprave të Tij.

b) T'i tregojë detyrën e adhurimit njerëzve.

Sipas kësaj, ç'vend mund të zënë avionët e njerëzve përpara planetëve dhe yjeve që janë si avionë në mbretërinë e Allahut që është Zoti i botëve? Nëse do të mendojmë nga ana e artit të hollë, arti që qëndron tek trupi i një mize është më i mrekullueshëm se të gjitha veprat e njerëzimit të marra së bashku.

Nëse do t'i shqyrtojmë këto mrekulli të qytetërimit nga ana e adhurimit, do të përballemi me një formë të ndotur nga ndjenjat materiale që të bëjnë të harrosh ahiretin. Ndërkohë, programi i rrethit të adhurimit është kështu: Kjo botë është një bujtinë, njeriu do të rrijë shumë pak në të. Detyra e tij është e bujtësit. Ai është i detyruar që brenda pak kohe jetese të përftojë gjërat e nevojshme për jetën e përhershme. Nga pikëpamja e adhurimit, që është formuar mbi bazën e mendimit të ahiretit, mrekullitë e qytetërimit kanë shumë pak nga kjo. Por ata shkencëtarë dhe zbulues të cilët për hir të Allahut punojnë vetëm për mirëqenien, rehatinë dhe lumturinë e njerëzve, që është adhurim tepër i vlefshëm, atyre

Kurani u ka dhënë shenja që do të jenë baza për frymëzimin e tyre. Dhe ato janë të mjaftueshme.

Pyetja e Dytë: Tani, nga ky shpjegim kuptojmë se Kurani përveç të vërtetave të tjera ka shenja në lidhje me mrekullitë e qytetërimit, zhvillimet shkencore e ndoshta për më tej. Çdo gjë që ndikon në lumturinë e kësaj bote dhe tjetrës së njeriut, i përfshin sa roli që ata luajnë. Atëherë përse Kurani nuk i përmend haptazi ato? A nuk mundej sikur t'i thoshte hapur, dhe të detyroheshin ta besonin edhe ateistët më inatçinj e të gjenim edhe ne rehati shpirtërore?

Përgjigje: Feja është sprovë. Urdhrat e Allahut janë sprova. Ashtu si një mineral hidhet në zjarr, që të ndahet qymyri me smeraldin, dheu me arin, po ashtu, obligimet hyjnore në këtë botë janë mundime dhe nxitje për konkurrencë. (Me qëllim që kështu) të ndahen nga njëri tjetri ndjenjat e larta tek njeriu nga ato të errëtat dhe shpirtrat e lartë nga ata të ulëtit.

Kurani ka zbritur në botën e provimit, në formën e një sprove, në sheshin e një konkurrence me qëllim që njerëzimi të arrijë gjendjen e përsosur. Padyshim që ai vetëm do të sinjalizojë për gjërat që do të duken në të ardhmen e botës, do të vërtetojë argumentet e tij dhe do i hapë udhë mendjes.

Nëse do të flitej haptas, do të zhdukej misteri i provimit dhe sprovës. Sepse në një provim që tregohen përgjigjet pasi janë bërë pyetjet, nuk mund të ndahen dot ata që kanë mësuar me ata që s'kanë mësuar. Nëse Kurani do i thoshte hapur të gjitha do besonin të gjithë. Do të ishte sikur të shkruhej në qiell me yje "*La ilahe il'lallah*" (nuk ka Zot tjetër përveç Allahut). Atëherë, dashur pa dashur, të gjithë do të pranonin. Nuk do të mbetej më, as konkurrim, as provim. Një shpirtkatran do të rrinte bashkë me shpirtrat e artë, Ebu Xhehli do të dukej njësoj me Ebu Bekrin, e do të humbte i tëri sekreti i provimit.

SHKENCA DHE TEKNOLOGJIA NË AJETET E KURANIT

Krijimi i universit, fazat e saj dhe gjendjet që ka kaluar, si dhe të gjitha të vërtetat të cilat studimet e fundit të shkencës dhe teknikës u janë afruar sot, i gjejmë të njëjta në Kuranin Famëlartë.

Kurani Famëlartë, të gjitha çështjet e saj ia ka vërtetuar qoftë mendjes (logjikës) ashtu edhe shkencës dhe sot, është e qartë se ato çka thuhen aty, janë plotësisht të njëjta me ato çka thonë të vërtetat shkencore. Pas kësaj hyrjeje të detyruar, le të hedhim një sy mbi ajetet në lidhje me shkencën dhe teknikën:

KRIJIMI I UNIVERSIT

"Dhe Ai është i Cili ka krijuar qiejt dhe tokën në gjashtë ditë dhe Arshi (Froni) i Tij ishte mbi ujë." (Hud/7)

"Pastaj Ai u ngrit lart drejt qiellit, ndërkohë që ai ishte tym." (Fusilet/11)

"A nuk e kanë ditur ata që mohojnë se qiejt dhe toka ishin të bashkuar së bashku si një njësi e vetme dhe Ne i ndamë ata?" (Enbija/30)

Në ajetet e mësipërme ka shenja për gjendjen në formë të lëngët dhe të gaztë të universit dhe për ndarjen e qiejve dhe tokës pasi ato ishin të bashkuara, si dhe tregon për galaktikat, Rrugën e Qumështit, sistemin Diellor dhe për rregullin e ekuilibrin e krijimit të tyre. Meqenëse Kurani i drejtohet çdo niveli dhe çdo kohe, është më e përshtatshme parapëlqimi i fjalëve ujë dhe tym në vend të termave lëng dhe gaz.

UNIVERSI ËSHTË I RRUMBULLAKËT

*"O grupim i xhind*ëve *dhe i njerëzve! Po patët fuqi për të kaluar përtej hapësirës (rrezeve) të qiejve dhe të tokës, atëherë kalojini. Por ju kurrë nuk do të mundeni t'i kaloni, përveç me fuqi (nga Allahu)."* (Rrahman/33)

Fjala "*aktar*" që përmendet në Kuran është shumësi i fjalës "*kutur*", që do të thotë rreze. Ndërsa rrezja gjendet tek trupat e rrumbullakët dhe rrethorë. Nga kjo kuptojmë rrumbullakësinë e tokës.

Sipas Ajnshtajnit, çdo gjë në univers është natyrisht në varësi të saj, në formë rrethore. Muhjidin Arabi i cili ka lindur në vitin 1165, në librin e tij *Futuhat,* shprehet kështu: "Allahu është zotërues i çdo përsosmërie, dhe në univers e ka treguar përsosmërinë e tij, qiejt i ka krijuar të përsosur. Ndërsa forma më e përsosur është rrethi. E për këtë Allahu e krijoi universin në formë të rrumbullakët. Edhe toka është e rrumbullakët dhe rrotullohet rreth boshtit të saj. Nga ky rrotullim formohen dita dhe nata."

QIEJT E MBËSHTJELLË

*"Dhe qiejt jan*ë të *mbështjell*ë *n*ë *Dorën e Tij"* (Zumer/67)

Nëse shihen me kujdes format e nebulozës dhe galaktikave, gjendja e tyre afërsisht e rrumbullakët, format e përthyera, animi drejt rrumbullakosjes dhe lëvizjet e sistemeve në formë spirale, e shprehin këtë.

FTOHJA E HËNËS

"Ne i kemi përcaktuar natën dhe ditën si dy shenja. Pastaj Ne e kemi shuar treguesin e natës, ndërsa e kemi bërë treguesin e ditës të ndriçuar." (Isra/12) dhe në ajetin *"A jeni ju më të vështirë për t'u krijuar, apo qielli të cilin Ai e ndërtoi? Ai e ngriti kupën e tij dhe Ai e ka renditur atë drejt dhe e ka përsosur. Natën e tij Ai e mbulon me errësirë dhe mëngjesin e tij Ai e nxjerr në dritë."* (Naziat/27-29) tregohet qartë për ftohjen e hënës.

UNIVERSI ZGJEROHET

"Ne qiellin e ndërtuam me fuqi. Sigurisht që Ne jemi të aftë ta zgjerojmë hapësirën prej këtej." (Dharijat/47)

Astronomia shprehet se universi sa vjen e zgjerohet. Gjithashtu thonë se nebulozat, grupet e yjeve, planetët dhe trupat qiellorë largohen prej njëri-tjetrit me shpejtësi të madhe. Universi po zgjerohet nga çdo anë. Njëlloj siç zgjerohet një tullumbace kur e fryjnë fëmijët. Ajeti *"Qiejt dhe toka ishin të bashkuar dhe Ne i ndamë ata."* (Enbija/30) shpreh këtë kuptim.

Kështu pra, hapësira (kozmosi) sipas Kuranit është një krijesë që nuk njeh mbarim, sa vjen plotësohet e rritet. Ja, pra, dhe "teoria e zgjerimit të universit" që nxori matematikani belg, Abbe Lemaitre, pas këtij zbulimi e që tronditi aq shumë Ajnshtajnin, që bëri fizikanin e madh Hubble të thoshte "nebulozat po largohen nga galaktika jonë."

LIGJET E TËRHEQJES-SHTYTJES-EKUILIBRIT

"Ai e mban qiellin të mos bjerë mbi tokë. Veçse me Lejen e Tij mund të bie." (Haxh/65)

"Ai ka krijuar qiejt pa shtylla mbështetëse që t'i shihni." (Llukman/10)

"Dhe qiellin Ai e ka ngritur lart dhe Ai ka vendosur ekuilibrin." (Rrahman/7)

Në ajetin e parë shpjegohet tendenca e qiellit për të rënë në Tokë që do të thotë tërheqje.

Në ajetin e dytë shpjegohet ndërtimi i qiejve pa shtylla. Këtë mund ta kuptojmë vetëm si fuqi e shtytjes. Ndërsa në ajetin e tretë, me shprehjen "vendosi ekuilibrin" përfshin të gjithë ekuilibrat që ekzistojnë në tokë.

TRAJEKTORET

"Dhe Ai është i Cili ka krijuar natën dhe ditën, diellin dhe hënën, e secili noton në orbitën e tij." (Enbija/33) *"(Trupat qiellorë) Ata të gjithë notojnë secili në një orbitë."* (Jasin/40)

Me të vërtetë, në mekanikën qiellore të sotme, pothuajse të gjithë e dimë se çdo trup qiellor ka një trajektore dhe një ekuacion të kësaj trajektore, edhe pse nuk mund të dimë detajet më të imta të saj.

PËRGJIGJE NJË KUNDËRSHTIMI

Duke thënë se disa mendimtarë të mëdhenj të antikitetit kanë ditur disa çështje që nuk mund të kundërshtohen dhe shkenca e sotme e ka pranuar këtë si të vërtetë, atëherë mund të kundërshtohen mrekullitë që na i ka servirur shkenca moderne.

Në radhë të parë, mendimtarët e antikitetit çështjet i studionin vetëm nga ana filozofike dhe nuk mbështeteshin në përfundime shkencore. Duke kundërshtuar, pothuajse harrohen fare gabimet e tjera të shumta të MËDHA të fryteve të mendimeve të filozofëve të asaj periudhe. Për shembull, ndjekësit e Pitagorës pranojnë se Dielli qëndron konstant në hapësirë dhe duke e pranuar atë si qendrën e universit, mendojnë se trupat e tjerë qiellorë e ndërtojnë ekuilibrin e tyre rreth tij.

Domethënë, mund të rastisim shpesh mendime të gabuara të filozofëve më të mëdhenj të periudhës së antikitetit në lidhje me universin. Fjalët e tyre të mëdha nuk duhet të na bëjnë t'i harrojmë gabimet e tyre. Vetëm në lëndët shkencore, asnjëra nga ata çfarë ka vërtetuar e zbuluar shkenca nuk bien ndesh absolutisht me ato ç'ka përmend Kurani. Pra, kjo është veçoria më e rëndësishme që e ndan Kuranin me të tjerat.

NDRYSHIMI MES DIELLIT DHE HËNËS

Kurani Famëlartë, kur flet për Diellin dhe Hënën, përdor veçori të ndryshme të tyre dhe shpreh zbulimet e fundit të shkencës para 1400 vjetësh:

"Është *Ai i Cili e bëri diellin ndriçues dhe hënën dritë*." (Junus/5). Në ndriçim ka nxehtësi dhe zjarr. Ndërsa drita është e kundërta e errësirës dhe është diçka e përftuar nga ndriçimi, që do të thotë bardhësi.

"Dhe e ka bërë hënën dritë në të dhe e ka bërë diellin llambë ndriçuese." (Nuh/16)

"Dhe Ne kemi bërë atje një llambë të shndritshme (Diellin)" (Nebe'/13)

Dielli, kur përmendet si llambë dhe kandil shpjegohet edhe përbërja e tij. Fjala "*Uehhaxh*" në suren Nebe' është shkalla superiore e fjalës "*uehexh*" që ka kuptimin ndriçimit me forcë e shndritje.

DIELLI

Në ajetin 38 të sures Jasin, thuhet se Dielli lëviz drejt një trajektore të caktuar. Me të vërtetë, Sistemi Diellor është drejtuar afër shenjës së Herkulit që sipas koordinatave të hapësirës është pranë Yllit Vega. Kjo lëvizje (e përcaktuar mirë) e ka shpejtësinë 19 km/orë.

12 PLANETET

Në Kuranin Famëlartë ka një përngjasim rreth Diellit, Hënës dhe 11 yjeve: *"Kujto kur Jusufi i tha babait të tij: "O Baba! Vërtet pashë (në ëndërr) njëmbëdhjetë yje, diellin dhe hënën duke më bërë sexhde."* (Jusuf/4)

Pas aventurës së gjatë, shohim se ëndrra e Hz. Jusufit plotësohet: *"Pastaj, kur hymë te Jusufi, ai i mori prindërit e tij pranë vetes dhe*

tha: Hyni në Egjipt të sigurt nëse dëshiron Allahu. Dhe (Jusufi) i ngriti prindërit e tij lart në fronin e ata ranë para tij në sexhde (për falënderim ngase e takuan atë). Ndërsa ai tha: O babai im! Ky është shpjegimi i ëndrrës sime të dikurshme!" (Jusuf/99-100)

Hëna dhe Dielli në ëndërr kuptojnë se janë prindërit e Profetit Jusuf. Këto të kujtojnë një sistem, një bashkësi që vjen prej një burimi. Dymbëdhjetë vëllezër së bashku me Jusufin (a.s) meqenëse kanë kuptimin e dymbëdhjetë vjeve, mbart në të njëjtën kohë edhe një shenjë të fortë për ekzistencën e dymbëdhjetë planetëve të Sistemit Diellor.

RRUMBULLAKËSIA E TOKËS

Ashtu siç u fol dhe më parë, në ajetin 33 të sures Rrahman flitet për rrezet e qiejve dhe të tokës, d.m.th. për rrumbullakësinë e tyre.

"Ai e bën natën të shkojë te dita dhe e bën ditën të shkojë te nata (mbulojnë njëra tjetrën)." (Zumer/5) Fjala "*tekvir*" ka kuptimin e rrumbullakosjes si mbështjellja e çallmës. Fraza tregon se Toka është e rrumbullakët. Në hadithin që transmeton Dejlemiu, Profeti thotë: "*Çallmat janë kurorat e engjëjve. Në çdo mbështjellje ka sevape.*" Fjala "*Kevr*" që përmendet në hadith, do të thotë mbështjellje që ka lidhje me rrumbullakësinë.

"Dhe pas kësaj Ai shtroi tokën. (në formë të rrumbullakët)". (Naziat/30) Fjala "*deha*" e cituar në ajet ka në rrënjë kuptimin e rrumbullakësisë. Vezëve që bëjnë strucët në rërë u thuhet "*Uhdijje*" dhe "*Uhduve*". "*Dahv*"do të thotë të hedhësh gurë ose arrë.

TOKA RROTULLOHET

"Dhe do t'i shohësh malet dhe do t'i mendosh (e do të të duken) të palëvizshëm, por ata lëvizin si lëvizja e resë." (Neml/88) Nga ky ajet, kuptojmë se toka qëndron si të ishte një re e varur në hapësirë. Këtu u tha vetëm lëvizja e maleve. Sepse kur një trup shumë i madh dhe i rrumbullakët, rrotullohet rreth boshtit të saj, nuk i ndjehet lëvizja. Vetëm me ndryshimin e vendndodhjes së majave mbi to mund të vihet re.

"*(Trupat qiellorë)* çdonjëri *prej tyre noton në një orbitë."* (Jasin/40) dhe (Enbija/33), shprehjet në këto ajete përfshijnë edhe tokën. *"Ai është i Cili e ka bërë tokën (si një kafshë) të dobishme dhe të përshtatshme për ju. K*është që ecni nëpër shpatullat e saj.." (Mulk/15)

"Ai sjell natën si mbulesë të ditës dhe secila duke synuar tjetrën pa ndërprerë." (A'raf/54) Gagarini pasi u kthye nga hapësira deklaroi se mbi sipërfaqen e tokës drita dhe errësira ndiqnin me një shpejtësi marramendëse njëra-tjetrën.

TOKA NGUSHTOHET NGA POLET

"A nuk e shohin ata se Ne vazhdimisht e pakësojmë tokën nga cepat e saj." (Enbija/44 dhe Rra'd/41)

Duke parë afërsinë mes shprehjes pakësimi i cepave, (zvogëlimi dhe tkurrja) me shprehjen gjeofizike të "shtypur në pole", mund të vërtetohet se forma e tokës është "ELIPSOIDE".

Trupat që rrotullohen prej kohësh rreth boshtit të saj marrin pikërisht këtë formë.

KUR NGJITESH LART PAKËSOHET OKSIGJENI

"Dhe Atë që Ai dëshiron ta humbasë, ia mbyll dhe ia shtrëngon gjoksin sikur të jetë duke u ngjitur në qiell." (En'am/125)

Nga kjo kuptojmë se personit që ngjitet lart për në qiell i ngushtohet kraharori. Toriçelli, këtë të vërtetë arriti ta shpjegojë me shifra vetëm në vitin 1643 në Firence, duke vërtetuar ekzistencën e trysnisë atmosferike. Sipas saj, sa më lart ngjitesh, oksigjeni pakësohet dhe si rrjedhojë lind vështirësia e frymëmarrjes dhe mbytja prej saj. Veçanërisht nga pakësimi i trysnisë atmosferike, gjaku vë në vështirësi damarët dhe zemrën, e bëhet sërish shkak për vdekje.

SHTRESA E ATMOSFERËS

"Dhe Ne e kemi bërë qiellin çati të sigurt dhe të mbrojtur më së miri" (Enbija/32)

Ky ajet krahas shumë kuptimeve të tjera, tregon se ashtu siç shtresa e atmosferës na mbron ne nga rrezatimet e dëmshme të Diellit, na mbron edhe nga rreziqet e meteorëve dhe trupave të tjerë qiellorë.

RRIZKU NË THELLËSITË E TOKËS

"Ai është i Cili krijoi për ju gjithçka brenda në tokë." (Bekare/29)

Mënyra e shprehjes në ajet, "brenda tokës" tregon se gjërat në barkun e tokës janë krijuar për ne. Këtu bëhet fjalë për pasuritë nëntokësore si nafta, mineralet dhe lëndët e ndryshme janë krijuar për njeriun, dhe lëndë e ushqime të tjera që ende nuk janë zbuluar, por që do të zbulohen në të ardhmen e që do të shpëtojnë njerëzit nga gjendja e vështirë ekonomike.

Gjithashtu, nga Profeti ynë i Nderuar (s.a.s) transmetohet një hadith i cili thotë: "Rrizkun kërkojeni në thellësitë e tokës."

ERËRAT SI PJALMUESE

"*Dhe Ne dërgojmë erërat ngarkuese*." (Hixhr/22)

Pasi u zbulua e vërteta që thuhet në ajetin e 3 të sures Rra'd: *"Dhe nga çdo lloj bime e fruti Ai bëri në palë dy e nga dy, meshkuj e femra"*, se çdo bimë e lule ka gjini mashkull e femër, dhe kjo vjen si rezultat i pjalmimit që i bën mashkulli femrës, kuptohet shërbimi që bën era si pjalmuese.

Ndërsa në ajetin e 43 të sures Nur, fraza: *"A nuk e shihni se Allahu i drejton retë me qetësi, pastaj i mbledh ato bashkë, pastaj i kthen ato në stivë shtresa-shtresa dhe veç sheh shiun të dalë nga brendësia e tyre. Ai dërgon nga qielli edhe male me breshër."*

Kuptojmë elektricitetin, i cili formohet nga çiftëzimi i reve të shiut që fillon me uljen poshtë të joneve pozitive dhe ngritjen lart të joneve negative. E gjitha kjo ndodh me anë të erërave.

ENERGJIA E LËVIZJES

"Derisa ato erëra të kenë sjelle re të ngarkuara rëndë..." (A'raf/57)

Si është e mundur që retë e rënda arrijnë të qëndrojnë mbi ajrin që është më i lehtë se ato vetë? Më përpara thuhej se: "Retë janë të përbëra nga pika të vogla uji. Këto janë si flluska sapuni dhe kanë ajër brenda tyre. Ngaqë ajri i brendshëm është më i nxehtë dhe me i lehtë se ajri i jashtëm, retë kanë mundësi të qëndrojnë në ajër si të varura." Kur u plotësuan mundësitë e studimit, u kuptua se brendësia e këtyre pikave nuk është bosh, por, përkundrazi, plot. Më së fundi u vërtetuan ato ç'ka kishte thënë Kurani. Erërat që vënë në lëvizje mullinjtë e erës dhe shkaktojnë stuhi me kokrrizat e rërës, mbajnë gjithashtu retë në ajër.

NJË KRAHASIM

Në faqen 45 të revistës "Shkenca dhe Teknika", Janar 1977, në artikullin "Fundi i Diellit", thuhej kështu: "Padyshim që ekuilibri nuklear do të ndryshojë pas një farë kohe. Bërthama e Diellit do të fillojë të përdorë heliumin, si pasojë do të rritet nxehtësia, Afërdita dhe Mërkuri do të shkrihen, oqeanet në tokë do të vlojnë, do të avullojnë dhe malet do të shkrihen të tëra.

Një ditë këto do të ndodhin. Brenda disa orësh Dielli do të zvogëlohet sa vëllimi i sotëm i Tokës dhe kur të digjet më në fund heliumi, Dielli do të bëhet si një copë qymyri i djegur. Ky fund, nuk do të mund të ndryshohet as edhe me njohuritë më të zhvilluara".

Tani, le t'i hedhim një sy me radhë ajeteve të Kuranit:

FUNDI I DIELLIT

"Kur dielli të mbështillet dhe të humbë dritën dhe të përmbyset." (Tekvir/1)

Fjala '*tekvir*' e përdorur në ajet ka kuptimin e rrumbullakosjes, mbështjelljes, përmbysjes e të verbuarit. Atëherë kuptimi është kështu: *"Kur Dielli të mbështillet e të përmbyset ose të qorrohet."*

OQEANET DO TË DIGJEN

"Dhe kur detet të bëhen zjarr i ndezur." (Tekvir/6)

Ky ajet i cili ka zbritur para 1400 vjetësh flet për djegien e oqeaneve gjatë kiametit (apokalipsit). A ishte e mundur kjo njohuri për njerëzit e asaj kohe? Ndërsa sot, ne e dimë fare mirë se uji përbëhet nga oksigjeni me veti djegëse (oksiduese) dhe nga hidrogjeni që digjet.

QIELLI DO TË SKUQET SI TRËNDAFIL E DO TË SHKRIJË SI VAJ

"Dhe kur qielli të çahet e të bëhet ngjyrë trëndafili e të shkrihet si vaj." (Rrahman/37)

"Ditën kur qielli do të jetë si fundërrinat e vajit të djegur, dhe malet do të jenë si shtëllunga leshi." (Mearixh/8,9)

"Pritni atëherë për Ditën kur qielli do të nxjerrë tym që do të

shihet qartë. Duke i mbuluar njerëzit, ky është një ndëshkim i dhimbshëm." (Duhan/10-11)

MALET DO TË SHKRIHEN

"*(Në atë Ditën e Gjykimit) kur njerëzit do të jenë si flutura të shpërndara andej këndej. Dhe malet do të jenë si lesh i hedhur shkujdesshëm*" (Karia/1-5)

"*Ditën kur toka dhe malet do të jenë në dridhje të fuqishme dhe malet do të jenë grumbull rëre i derdhur që rrjedh.*" (Muzemil/14)

"*Dhe malet do të shkulen nga vendi dhe do të duken sikur të kishin qenë vegim.*" (Nebe'/20)

MË E VOGËL SE ATOMI

"*As ti nuk bën ndonjë vepër, as nuk këndon ndonjë pjesë nga Kurani; dhe as ju nuk bëni ndonjë vepër, veçse Ne jemi Dëshmues mbi ju kur ju e kryeni atë. Dhe asgjë nuk i fshihet Zotit tënd qoftë sa një grimcë* në tokë apo në qiell qoftë, dhe as çfarë *është më e vogël se ajo dhe as çfarë është më e madhe veçse shkruhet në Librin e Qartë (Kitabi Mubin)"* (Junus/61)

Nga shprehjet "sa një grimcë "dhe " më të vogël se ajo, pra grimca" kuptojmë:

a) Masën e atomit

b) Se ekzistojnë gjëra më të vogla se atomi

ÇDO GJË ËSHTË KRIJUAR ÇIFT

"Lavdi i qoftë Atij i Cili ka krijuar gjithë palët (çift) e atyre që prodhon toka si dhe nga vetë lloji i tyre, dhe nga ato gjëra që ata nuk i dinë." (Jasin/36)

"Edhe nga çdo gjë Ne kemi krijuar dy palë që ju të mund të përkujtoni (mirësinë e Allahut)" (Dharijat/49)

"Dhe nga çdo lloj bime e fruti Ai bëri në palë dy e nga dy." (Rra'd/3)

Ekzistenca e dy gjinive tek bimët u mësua vonë. Pas shumë shekujsh u fol për anën pozitive dhe negative në elektricitet dhe në atome. Bërthama e atomit ka ngarkesë pozitive, ndërsa elektronet kanë ngarkesë negative. Më interesantja është se edhe tek bërthama e atomit madje ekziston koncepti i "çiftit" (dyzimit). Sepse ajo formohet nga bashkimi i protonit me neutronin.

NJERIU NGA TOKA

"Dhe nga treguesit e Tij është se Ai ju krijoi ju prej dheu." (Rrum/20)

Shkenca e ka vërtetuar se thelbi i trupit të njeriut përbëhet nga karboni, oksigjeni, hidrogjeni, squfuri, fosfori, azoti, kalciumi, magneziumi, bakri, jodi, fluori, kobalti, zinku, siliciumi, alumini etj. Ajetet 49, 50, 51 të sures Isra hedhin dritë mbi këtë çështje: *"Dhe thonë: çfarë?! Kur të jemi eshtra e thërrime vërtetë që do të ringjallemi për të qenë një krijim i ri? Thuaj (O Muhamed): Në daç qofshi gurë apo hekur..."*

A nuk ka hekur në trupin e njeriut? Cili është shkak për ngjyrën e kuqe që ka gjaku ynë? Mineralet a nuk janë nëna e tokës?

FAKTORI PËRCAKTUES I GJINISË

"A mendon njeriu se do të lihet i harruar? A nuk qe ai një lëng i ngjizur e i derdhur (spermë)? Pastaj u bë një gjak i mpiksur pastaj (Allahu) i dha trajtë dhe formë atij në përpjesëtimin e duhur. Dhe bëri prej saj çiftin, mashkullin dhe femrën." (Kijame/36-39)

Nga fraza e ajetit kuptojmë se faktori mashkull femër i përket spermës së mashkullit. Ja, një e vërtetë shkencore që u vërtetua vetëm në shekullin e XX.

TRE ERRËSIRAT NË BARKUN E NËNËS

"Ai ju krijon ju në barkun e nënave tuaja krijim pas krijimi nën tri perde errësire." (Zumer/6) E vërteta shkencore që flet për tri errësirat u kuptua tani vonë. Gjinekologjia thotë se mitra e nënës është e rrethuar me tre cipa që nuk futin brenda ujë, dritë dhe nxehtësi. Këto janë cipat MUHBAR që s'lejon ujin; AMNIONI që s'lejon dritën dhe KORIONI që s'lejon nxehtësinë.

SHENJAT E GISHTËRINJVE

"A mendon njeriu se Ne nuk do t'i mbledhim eshtrat e tij? Po sigurisht! Ne jemi të zotë t'i vendosim e t'i rendisim në mënyrë të përkryer shenjat e gishtave të tij." (Kijame/3-4). Në këtë ajet krahas organeve të tjera të njeriut, të tërheq vëmendjen përmendja e gishtave.

Majat e gishtave kanë ndarje të vogla të veçanta ku asnjëri

s'ngjan me tjetrin. Veçoritë e shenjave të gishtërinjve nuk njiheshin deri në shekullin e XVIII. Në vitin 1844, Anglia pranoi zyrtarisht shenjën e gishtave si shenjën njohëse dhe dalluese më të mirë midis personave. Këto dredhëza tek mollëzat e gishtave pranohen nga mjekësia se nuk ndryshojnë gjatë gjithë jetës së njeriut.

FRYMËZIMI QË U VJEN BLETËVE

"Dhe Zoti yt edhe bletën duke i thënë: "Ndërtoji shtëpitë e tua në male, në pemë dhe ndërtimet e njerëzve. Pastaj hani nga çdo lloj fruti dhe ndiqni rrugët që Zoti juaj ua bëri të lehtë për ju." (Nahl/68-69)

Bletët e vogla të sapoardhura në jetë arrijnë të fluturojnë një ditë të tërë pa humbur orientimin e tyre dhe kthehen me shtysën hyjnore përsëri në kosheren e tyre.

Hojet dhe qelizat që bëjnë bletët janë të mbuluara me një kapak në formë gjashtëkëndore. Kjo formë gjashtëkëndore bën më të lehtë hyrjen e bletëve brenda saj. Nëse hojet do të ishin në formë rrethore, mes qelizave do të humbte shumë mjaltë. Ndërkohë që në sajë të formave gjashtëkëndore hojet puthiten mirë me njëra-tjetrën pa lënë hapësirë. Për këtë çështje janë bërë studime për formën më të përkryer dhe është pranuar dhe gjetur forma gjashtëkëndore si më e mira prej tyre.

MJETET MOTORRIKE

"Betohem për (kuajt) që vrapojnë me gulçim; duke nxjerrë xixa (me thundrat e tyre), dhe që hidhen në sulm në agim. Dhe ngrenë pluhur si re ndërkohë, dhe duke depërtuar me to në mes..." (Adijat/1-5)

Këto ajete nuk tregojnë vetëm për kalorësinë, por japin shenja edhe për mjetet motorike dhe armët e zjarrit të cilat sulmojnë me shpejtësi të lartë.

"Ai ka fuqi të dërgojë ndëshkim mbi ju nga lart ose nën këmbët tuaja, ose t'ju mbulojë me ngatërresa dhe t'ju bëjë që të shijoni urrejtje e dhunë nga njëri-tjetri". (En'am/65)

Dënimi që vjen nga lart, rënia e rrufesë, rrebeshet me gurë, tufanet e ndryshëm; Dënimi që vjen nga poshtë si tërmeti, rrëshqitja e tokës si dhe dalja e ujit dhe zjarrit, "*Ka fuqi t'ju mbulojë me ngatërresa dhe t'ju bëjë që të shijoni urrejtje e dhunë nga njëri tjetri.*" Në këtë ajet ka shenja për bombardimet e avionëve, raketat, nëndetëset, shkatërrimet e minave dhe për dënime të ngjashme ose më të përparuara.

"A nuk e sheh si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit? A nuk bëri Ai që përbetimi i tyre të humbë e të dështojë? Dhe Ai dërgoi kundër tyre zogj tufë-tufë. Duke i qëlluar ata me gurë (baltë e pjekur e gurëzuar). E kështu i bëri ata si koçanë të ngrënë." (Fil/1-5)

Gjendja dhe pozicioni i zogjve kundrejt armiqve tregon për avionët dhe plumbat që komandohen nga larg.

ANIJA E HZ. NUHUT NUK ISHTE ME VELA

"Dhe Ne e mbartëm (Nuhun) në varkën e ndërtuar me dërrasë e gozhdë". (Kamer/13)

"Dhe e bëmë varkën si një tregues mirësie." (Ankebut/15)

"Dhe vërtet që Ne e kemi lënë (anijen) si tregues." (Kamer/15)

"Dhe ndërtoje anijen para Syve Tanë dhe me Frymëzimin Tonë dhe mos *m'u drejto Mua për ata që bënë padrejtësi dhe humbën.*

Nuk ka dyshim se ata do të mbyten. (Kështu që) Derisa atje arriti Urdhri Ynë (saqë) edhe furra derdhi (ujë si burim) atëherë Ne thamë: "Hipni në anije nga çdo lloj dy çift." (Hud/37, 40)

Ajetet na tregojnë se kjo anije nuk ka qenë me vela por ka qenë si një vapor me oxhak dhe avull që e prodhon vetë energjinë e lëvizjes. Fraza: "*Derisa atje arriti Urdhri Ynë (saqë) edhe furra derdhi (ujë si burim) atëherë Ne thamë: "Hipni në anije*" kërkon vëmendje.

Termi "*teennur*" që përmendet në ajet ka kuptimin e një oxhaku të mbyllur dhe të një furre. Ndërsa fjala `*feveran*` ka kuptimin e vlimit dhe të zierjes së fuqishme. Ndërkohë ne nuk kemi dyshim se kur flitet për anijen dhe jepet urdhri për t'u nisur në kohën e vlimit të oxhakut, anija ishte në gatishmëri për tu nisur.

TRENI DHE MJETET E TJERA

"Ai ka krijuar edhe kuajt, mushkat, gomarët për ju për t'i ngarë dhe për hijeshi. Ai krijon edhe gjëra të tjera që ju nuk keni aspak dije." (Nahl/8)

"Dhe një shenjë për ta është (ajo) se Ne mbartëm pasardhësit e tyre në barkën e ngarkuar rëndë(të Nuhut). Dhe Ne kemi krijuar po si ajo për ta, të cilat i ngasin e udhëtojnë." (Jasin/41-42)

Këto ajete krahas kafshëve transportuese të njohura dhe anijeve me vela, japin shenja edhe për trenin, avionin, makinat dhe llojet e tjera.

TENDOSJA SIPËRFAQËSORE {SURFACE TENSION}

*"Ai i ka çliruar dy detet (uj*ërat e kripura dhe të ëmbla) të takohen bashkë. Ndërmjet tyre është një pengesë (kufi që i dallon të dy) të cilën asnjëri prej tyre nuk mund ta shkelë." (Rrahman/19-20)

Në ngushticën e Bosforit ka dy rryma që kanë drejtime të ndryshme. Sipas gjendjes së kripërave vazhdojnë rrjedhjet e tyre pa u përzier. Në lindje të Pakistanit janë dy lumenj që rrjedhin drejt qytetit Erkan. Një vizë i ndan ata nga njëri tjetri. Nga njëra anë ka ujë me kripë, në anën tjetër ujë të ëmbël; dhe rrjedhin në një ekuilibër të plotë.

Në qytetin *Alal-Abad*, në pikën ku bashkohen lumenjtë *Kenc* dhe *Xhamuma*, ujërat e tyre nuk përzihen me njëri tjetrin dhe nuk ka as ndonjë vizë që t'i ndajë ata në mes. Shkaku për këtë bëhet tendosja sipërfaqësore. Ky ligj i ndan dy lëngjet nga njëri tjetri. Sepse "forca tërheqëse" që ka molekula e njërit lëng është krejt e ndryshme nga e tjetrës. Kështu pra, të dyja lëngjet e ruajnë gjendjen e tyre.

Është tendosja sipërfaqësore ai ligj që pengon përzierjen e vajit të ullirit me ujin dhe ujin e ëmbël me ujin me kripë.

KOHA DHE RELATIVITETI

Kurani Famëlartë temën e kohës e ka trajtuar në mënyra të ndryshme. Vitet që i kalojnë milionat i përdor si një ditë që nënkupton një periudhë të caktuar, një ditë qiellore si 1000 vjet për ne, një ditë hyjnore si 50.000 vjet për ne. Edhe periudhën prej

309 vjetësh ata persona të cilëve iu duk sikur të kishte kaluar një ditë apo gjysmë dite, ia lë botëkuptimit të tyre {As'habi Kehf}.

"Dhe një ditë tek Zoti yt është sa një mijë vjet sipas llogarisë suaj." (Haxh/47)

"Engjëjt dhe shpirti ngjiten tek Ai në një Ditë, përmasat e së cilës janë sa për pesëdhjetë mijë vjet." (Mearixh/4)

Sipas nesh, d.m.th. sipas ne tokësorëve, nëse do të bëjmë një krahasim, toka kryen një rrugë prej 29,8 km në sekondë. Shpejtësia e engjëjve dhe e shpirtit:

29,8 x 365 x 50.000 = 547.500.000 km/sek.

E kjo në krahasim me shpejtësinë e dritës:

547.500.000 / 300.000 = 1825 herë më shumë.

Domethënë, engjëlli dhe shpirti janë 1825 herë më të shpejtë se shpejtësia e dritës. Nga kjo pikë, për ne mbetet e pamundur t'i shohim me sy ato në lëvizje. Sepse shikimi është i lidhur me rrezatimin e dritës. Drita, nuk mund të arrijë diçka që është më e shpejtë se ajo vetë që ta rrezatojë. Por mund ta shohë vetëm si përngjasim. (Merjem/17)

Ajnshtajni, pranonte se në tokë nuk ekzistojnë trupa të lëvizshëm që e kalojnë shpejtësinë e dritës. Më pas, shkencëtari i Fizikës në Universitetin e Kolombias, Dr. Gerald Feinberg, hodhi një teori të re në fizikë. Sipas kësaj teorie, ekzistojnë edhe trupa të vegjël që e kalojnë shpejtësinë e dritës. Këto ai i quan "TACHYONS" (të shpejtit).

Përderisa engjëjt janë krijuar nga drita dhe nuk mund të kufizohen dot nga tre dimensione, është normale që të jenë më të shpejtë se trupat, valët dhe nga drita që ka lidhje me trupat.

MË SHUMË SE TRE DIMENSIONE

"Dhe nxitoni në rrugën (që të udhëheq) drejt faljes nga Zoti juaj dhe drejt xhenetit të gjerë sa hapësira e qiejve dhe i tokës, i përgatitur për të devotshmit." (Al-I Imran/133)

Nëse toka dhe qiejt janë gjerësia e diçkaje, d.m.th. nëse hapësira tredimensionale që njohim është vetëm një gjerësi, do të nevojiten lartësi dhe gjerësi tjetër për xhenetin për të cilin flitet. Pika nuk ka dimension. Vija ka vetëm një dimension. Sipërfaqja është dydimensionale. Vëllimet që njohim janë tredimensionale. Ndërsa Kurani me frazën e tij "*një xhenet i gjerë sa hapësira e qiejve dhe tokës*" flet për dimensione më shumë se tre që nuk ia dimë numrin.

ELEKTRICITETI

2*"Allahu është drita e qiejve dhe e tokës. Shembulli i dritës së Tij është si të kishim një qoshe të errët dhe në të një llambë, llamba e futur në një kupë qelqi, kupa e qelqit si të ishte yll që shkëlqen i ndezur nga një pemë e bekuar, nga ulliri, as nga lindja, as nga perëndimi, vaji i të cilit digjet vetvetiu edhe pse nuk e ka prekur zjarri fare. Dritë përmbi dritë!"* (Nur/35)

Mishkat: quhej vendi në të cilin vendoseshin pishtarët në muret e kështjellave.

Misbah: do të thotë kandil, llambë.

Dhuxhaxhe: ka kuptimin e xhamit.

Shprehja "*zjarr në kupë qelqi*" është shenjë për yjet që u vjen drita konstante dhe me shkëputje si e shkelura e syrit. Gjithashtu tregohet edhe dallimi mes planetëve e të tjerëve. Në të njëjtën

kohë tregohet edhe për rrymën alternative që kanë dritat tona që fiken më shumë se 60-70 herë në sekondë.

Fraza "*I ndezur nga një pemë e bekuar nga ulliri, as nga lindja, as nga perëndimi",* tregon një energji tjetër të bekuar përveç vajit të ullirit. Në kohët e vjetra ngaqë vaji i ullirit përdorej si lëndë djegëse, me anë të kësaj shprehje të vjen në mend edhe energjia e një llambe komplet tjetër. Përderisa nuk është as nga lindja e as nga perëndimi, është një energji e re e bekuar për njerëzit. Përmendja e ndriçimit të saj pa prekur zjarr, të sjell ndërmend kuptimin e një energjie që ndriçon pa flakë.

"Do të çohet kundër jush (ju xhindëve dhe njerëzve) flakë zjarri pa tym dhe tunxh i (shkrirë) dhe nuk do të mundeni të mbroni veten tuaj. Atëherë cilën nga mirësitë e Zotit tuaj ju e mohoni." (Rrahman/35-36)

Siç dihet, telat e hollë të bakrit të izoluara janë të shtruara në të gjitha cepat e shtëpisë tonë dhe duke ju dhënë elektriciteti nga një qendër, mund të shpërndajnë energjinë elektrike kudo, pa patur nevojën e një zjarri si shkrepësja. Nëse njeriu do të prekte telin e paizoluar, do ta dridhte elektriciteti. Dhe nëse ndokush do ta kapte për ta shpëtuar, do të binte vetë në të njëjtin rrezik.

Elektriciteti që është kaq i fuqishëm është bërë për ne shërbyesi më i urtë. Prej kësaj, është thënë edhe "C*ilën nga mirësitë e Zotit tuaj ju e mohoni?"* Po, përveçse ndriçon, ky burim fuqie që na ngroh, freskon, dhe vë në punë e lëvizje mjete të shumta pa zhurmë e pa tym, është padyshim një mirësi e madhe!

Muhjiddin Arabi, në librin e tij "Futuhati Mekkije" flet për gjendjen '*Ilmul intikas uel in'ikas fin-nur uen-nuhas*' (dija e kthimit prapa dhe rënies poshtë brenda dritës dhe bakrit) përmbledh rënien poshtë të ujit të gotës si kalim i energjisë në mjete elektrike nga poli negativ në atë pozitiv. Muhjiddin Arabi i cili ka vdekur në vitin 1213, ka zbuluar të vërtetat shkencore që përmbajnë fjalët

"*Shuvaz* dhe *Nuhas*" në ajetin e 35 të sures Rrahman. Kështu, ai ka vërtetuar mrekullinë e Kuranit dhe gjenialitetin e tij.

"Betohem për erërat që shpërndajnë pluhur (grimcat)! (Për retë) që mbartin peshë të rëndë uji! (Për anijet) që notojnë lehtë e qetë! (Për ata engjëj) që shpërndajnë (rrizk, shi e mirësi të tjera) me Urdhër (të Allahut)! Vërtet se ajo që ju është premtuar (ringjallja) është padyshim e vërtetë." (Dharijat/1-5)

Mjafton një mendim i thjeshtë për të parë se si këto ajete përmbledhin në një trajtë të përmbledhur përbërjen dhe funksionin e elektricitetit.

Shpërndarja e grimcave (d.m.th. era elektrike që fryn me shpejtësi 300.000 km në sekondë dhe ndan elektronet nga bërthama) që mbart peshë (d.m.th. ngarkesë negative, duke mbartur ngarkesë elektrike) si pasojë e lëvizjes lehtë e qetë (shpërndarja e energjisë që përftohet në diga dhe centrale tek makineritë dhe punesa të ndryshme) ashtu siç është e vërtetë (d.m.th. ashtu siç ju njerëzit e sotëm i zbuluat dhe i mësuat këto) atyre që u premtohet (d.m.th. lajmit se Islami do të triumfojë dhe për ringjalljen pas vdekjes) padyshim që e vërtetë është (edhe ato do ndodhin). Dhe nuk ka asnjë dyshim se do të kërkohet llogari (do të merrni atë që meritoni)."

TRANSMETIMI I NJËJTË I GJËRAVE

"Ai (Sulejmani) u tha:

- O udhëheqës! Cili prej jush mund të më sjellë mua fronin e saj para se ata të më vijnë të nënshtruar me bindje?

Një Ifrit (më i fuqishmi) nga xhindët tha:

- Unë do ta sjell atë ty para se të ngrihesh prej vendit. Dhe vërtet që jam i fortë dhe i besueshëm për një shërbim të tillë.

Njëri që kishte Dije për Librat (e Shenjtë) tha:

- Do të ta sjell atë ty sa të hapësh e të mbyllësh sytë!

Pastaj kur (Sulejmani a.s.) e pa të vendosur para tij ai tha:

- Kjo është nga mirësia e Allahut. " (Neml/38-40)

Nga fraza e këtij ajeti kuptojmë se sendet mund të transmetohen (transportohen) njëlloj ose vizualisht.

Radio dhe televizioni ka treguar se mund të transmetojë zërat dhe pamjet. Ndërsa transmetimi (transportimi) ashtu siç është i sendeve që flet Kurani ende nuk është zgjidhur.

Një pikë tjetër që mësohet nga ajeti është dallimi mes shpejtësisë së Ifritit dhe shpejtësisë së forcës së tërheqjes. Sepse Ifriti thotë: "*Unë ta sjell ty atë ende pa u ngritur nga vendi yt*". Ndërsa ai që njihte shkencën e xhelbit (tërheqjes) thotë: "*Ta sjell pa mbyllur sytë*".

TRANSMETIMI I AROMAVE

"Ndërsa kur karvani u largua nga (Egjipti për në Kenan) babai (Jakubi a.s.) i tyre tha: vërtet që e ndiej erën e Jusufit." (Jusuf/94)

Për të shprehur kuptimin e aromës këtu është përdorur termi "*ruh*". Ndërsa *rîh* do të thotë erë. Nga ky kuptim, ka mundësi që ardhja e aromës të jetë me valët elektronike dhe jo me lëvizjen masive të ajrit. Duke ndjekur fushën e kimisë dhe fizikës atomike, shikojmë se është e mundur që me një ligj më të detajuar se ai i transmetimit të zërit, të përfitohet nga zotërimi i fuqisë dhe lëvizjes.

Në të vërtetë, ndjenja e Jakubit (a.s.) më shumë se shkencore është mrekulli. Por nga ajo çka kuptojmë nga fraza e ajetit, është arritja e kësaj arome bashkë me erën në momentin që karvani i lajmit të mirë që mbartte me vete këmishën niset nga Egjipti. Dhe

kjo tregon për ekzistencën e një ligji të fshehtë të lëvizjes së aromës në ajër pa tela, njëlloj si rrufeja.

GJUHA E SHPENDËVE

"Dhe Sulejmani trashëgoi (dijen dhe profetësinë) nga Davudi dhe ai tha: O njerëz! Na është mësuar gjuha e shpendëve dhe na është dhuruar gjithçka (për ç'vlen gjuha)." (Neml/16)

Në fakt, logjika dhe e folura kanë të njëjtën rrënjë (origj. *mantik* dhe *nutuk*). Nisur nga kjo logjikë, mësojmë se Hz. Sulejmani jo vetëm që kuptonte ndjenjat që dëshironin të shprehnin shpendët me të folurën dhe lëvizjet e tyre, por kuptonte gjithashtu logjikën dhe gjendjen e brendshme të tyre. Këto fjali tregojnë se Allahu u kishte mundësuar Hz. Davudit dhe Hz. Sulejmanit të kuptonin gjuhët e llojeve të shpendëve dhe vlerat e tyre.

Po, përderisa është e vërtetë, përderisa rruzulli tokësor është një sofër hyjnore që i është servirë nderit të njeriut; atëherë kushdo që i shërben njeriut nga ajo sofër, kafshët e tjera dhe shumica e shpendëve mund t'i binden njerëzve dhe t'i shërbejnë atyre. Ashtu si duke vënë në shërbim me një frymëzim hyjnor kafshët më të vogla si bleta dhe krimbi i mëndafshit, duke përdorur pëllumbat në disa punë dhe duke bërë disa zogj si papagalli të flasin, i ka shtuar bukurive të qytetërimit njerëzor gjëra të mrekullueshme. Po në të njëjtën formë, nëse do njihen aftësitë dhe gjuhët e kafshëve të tjera, ka shumë specie që ashtu si simotrat e tyre të buta mund të përdoren në punë të rëndësishme. Për shembull, kundrejt fatkeqësisë dhe shtimit të karkalecave, nëse dihet gjuha dhe e zogjve që i shkatërrojnë ata pa i ngrënë dhe kontrollohen lëvizjet e tyre, kemi mundësi të përfitojmë një shërbim aq të vlefshëm pa paguar asgjë.

*"(Zogjtë në zbrazëtirën e qiellit) nuk i mban ata veçse Allahu q*ë

ë*shtë i Plotmëshirshëm*." (Nahl/79)

"*A nuk i shohin ata zogjtë sipër tyre duke hapur krahët e tyre e duke i palosur? Askush nuk i mban ata përveç të Gjithëmëshirshmit (Allahut).*" (Mulk/19)

Shkenca moderne mund të arrijë të krijojë lidhje të forta me ajete të cilat tregojnë për lëvizjet e zogjve të cilat janë plotësisht të lidhura me urdhrin e Zotit. Njohuritë aktuale, kanë treguar se në ç'pikë mahnitëse kanë arritur zogjtë në programimin e fluturimit të tyre. Në kodin gjenetik të kafshëve ka një program të regjistruar për shtegtimin e tyre. Vetëm me anë të një programi të tillë është e mundur të shpjegohet udhëtimi shumë i komplikuar dhe në vise të largëta i tyre. Sepse zogjtë e vegjël që nuk kanë patur aspak përvojë më parë dhe nuk kanë ndihmës me vete, kanë aftësinë ta plotësojnë këtë shtegtim të tyre në kohën e përcaktuar.

Prof. Hamburger, në librin e tij me titull "*La Puissance et La Fragilite*" tregon si shembull zogun "*Matton-Bird*" i cili kryen një fluturim në formën e tetës përgjatë 25.000 km mbi Oqeanin Paqësor. Pranohet se në qelizat nervore është e regjistruar një direktivë e tillë. Ato direktiva janë të gjitha të programuara.

QIELLI RREZATUES DHE KTHYES

"Betohem përqiellin (meretë eshiut) i cili ka aftësi kthimi." (Tarik/11)

Domethënë çdo gjë që ngrihet në qiell kthehet në tokë. Avujt e ujit kthehen si shi. Trupat kthehen nga forca tërheqëse e tokës. Valët hapësinore me rrezatimin e tyre kthehen nga shtresa e jonosferës. Rrezet e ngrohta infra të kuqe kthehen me të njëjtën mënyrë në tokë duke e ngrohur atë natën.

Ndërkohë, qielli rrezaton ato që i hidhen nga toka. Veçanërisht

ato që i hidhen nga bota e jashtme i rrezaton dhe i shpërndan. Duke mbrojtur kështu tokën nga rrezet vrasëse të universit dhe rrezet ultraviolet. Sikur qielli të ishte një tavan aktiv…

LËNDA E OKSITOSINIT

"Ndërsa dhimbjet e lindjes e çuan te trungu (Merjemin) i një hurme. Ajo tha: Ah sikur të kisha vdekur përpara kësaj dhe të isha harruar. Pastaj një zë poshtë saj i thirri: -Mos u pikëllo! Zoti yt ka siguruar për ty një çurg uji aty poshtë teje. Dhe shkunde trupin e hurmës nga ti, do të lëshojmë mbi ty hurma të freskëta e të pjekura. Kështu që ha e pi e ji e kënaqur." (Merjem/23-26)

Përse hurma të njoma? Në studimin më të fundit për hurmat e njoma, thuhet kështu: tek hurma gjendet një lëndë e ngjashme me Oksitosinën që ndalon rrjedhjen. Sepse është një lëndë zbutëse. Është bërë e njohur tashmë nga mjekësia se frutat zbutës, për nga ana e pastrimit të zorrëve të trasha, lehtësojnë fazën e lindjes.

Profeti ynë i nderuar, në një hadith i këshillon grave shtatzëna të hanë hurma. Ashtu siç dihet edhe sot, lënda e oksitosinit lehtëson lindjen dhe shton prodhimin e qumështit.

GËRMAT E KODUARA

Disa prej sureve të Kuranit nisin me disa germa të veçanta të cilat lexohen të ndara e që quhen *hurufu mukattaa*. Nga shumë urtësi që bartin ato, le të citojmë disa të cilat janë kuptuar deri tani: për shembull le të marrim suren Kaf. Në këtë sure ka gjithsej 57 germa 'Kaf'. Pas kësaj sureje vjen surja Shuara e cila për nga

gjatësia është sa dyfishi i sures 'Kaf'. Dhe në hyrje të kësaj sureje është germa "Kaf" dhe ka gjithsej 57 të tilla në tërë suren. A është kjo një rastësi? Sigurisht që jo.

Le t'i mbledhim:

57+57=114

(Sa numri i sureve të Kuranit)

Le të kujtojmë si nis e përfundon surja Kaf; "*Kaf, ue'l Kuran'il mexhid*…" dhe përfundon me: "*Fedhekkir bi'l Kurani men jehafu ueid*." Sikur "Kaf" personifikon Kuranin, d.m.th. germa "k" simbolizon Kuranin; si numri i *Kaf*-eve dhe i sureve të Kuranit tregojnë 114.

Surja Rra'd nis me *Elif, Lam, Mim, Ra*. Nëse numërohen germat brenda kësaj sureje shohim se ata janë të renditura nga lart poshtë dhe sipas vlerave të ebxhedit:

Elif : 625

Lam : 479

Mim : 260

Ra : 137 herë.

Një ekuacion i bukur!

Germat që nis surja Bekare:

Elif : 4592

Lam : 3204

Mim : 2195 herë përsëriten.

Gërmat që nisin suren Al-i imran:

Elif : 2578

Lam : 1885

Mim : 1251 herë përsëriten.

Në suren Ankebut:

Elif : 784

Lam : 554

Mim : 344 herë.

Në suren Rrum:

Elif : 547

Lam : 396

Mim: 318 herë përsëritet.

Këto llogari janë punimet e dijetarit egjiptian me banim në Amerikë, Reshat Halife. Në librin e tij "MIRACLE OF THE QURAN" ai paraqet shumë njohuri.

Gjërat që u përmendën nuk janë rastësi. Në të vërtetë ndodhemi para ligjeve të pakontestueshme dhe germave të llogaritura. Çdo germë është vendosur me një masë (kriter): "Allahu është ai i Cili ka zbritur Kuranin me të vërtetën dhe me peshojë (masë)." (Shura 17).

Cilën peshojë? Ne gjendemi para një ekuilibri germë për germë. Mendimi se "Kuranin e shkroi Profeti dhe thotë ato çka mblodhi nga paraardhësit e tij" ka falimentuar para germave *Elif, Lam, Mim, Ra* të sures Rra'd. sepse kjo imtësi sapo është zbuluar. S'mund të jetë vepër e atij shekulli. Profeti (s.a.s) do merrej me përcaktimin e shprehjeve të mrekullueshme apo me llogaritë e germave? Ne e dimë se Kurani ka zbritur pjesë-pjesë në një periudhë 23 vjeçare. Përderisa shkaqet e zbritjes kanë qenë të ndryshme si do të përcaktoheshin këto ekuacione?

Libri në lidhje me numrin 19 të Dr. Reshatit është gjithashtu mjaft interesant. Le të përmendim disa:

Numri i sureve të Kuranit është 114 që është shumëfish i 19.

D.m.th. : 19 x 6 = 114.

Bismil'lahi i shkruar me germat origjinale ka 19 germa.

Fjala e parë "*ism*" përmendet 19 herë në Kuran.

Fjala e dytë "Allah" përmendet 2698 herë, d.m.th. 142 x 19.

Fjala e tretë "Rrahman" përmendet 57 herë, d.m.th. 3 x 19.

Fjala e katërt "Rrahim" përmendet 114 herë, d.m.th. 6 x 19.

Në Kuran dy sure nisin me germën "*Kaf*": surja Kaf dhe Shura. Në suren Kaf germa "kaf" përsëritet sa trefishi i 19, pra 57 herë. Po e njëjta gjë ndodh dhe tek surja Shura megjithëse kjo është 2.5 herë më e gjatë se surja Kaf.

Gjithashtu ka një pikë ku duhet tërhequr vëmendja: Në ajetin 17 të sures Kaf thuhet: "*Ue Adun ue Fir'aunu ue ihuanu Lut*." Ky ajet është ndër ajetet të cilat janë kaluar pa u menduar e studiuar mirë. Por nëse shikojmë me kujdes në Kuran, ne lexojmë gjithmonë "*Kaumu Lut*" (populli i Lutit). Vetëm në suren Kaf e gjejmë atë në formën "*ihuanu Lut*" (vëllezërit e Lutit). Nëse do përdorej në këtë sure fjala "*Kaum*", atëherë numri i germave "Kaf" në këtë sure do bëhej 58, dhe nuk do ishte shumëfish i 19-ës, do të prishej kodi.

QËLLIMI KRYESOR I KURANIT

Çështjet në lidhje me shkencën dhe teknologjinë gjenden në Kuran për këto arsye:

a) Vërtetimi i parimeve të besimit

b) Për të treguar ekzistencën e shkencave brenda në Islam

c) Për të nxitur përfitimin nga mundësitë që jep teknologjia

Sepse Kurani nuk është as libër fizike e as kimie. Ai kryesisht bazohet në çështjet e TEUHIDIT (njësimit), NUBUVETIT (Profetësisë), HASHRIT (ringjalljes), dhe ADALETIT (drejtësisë). Si rrjedhojë, flet edhe për çështje shkencore.